REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 1130/20
Datë/Datum. 02-02-2021
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.1130/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paqarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K-Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "ALBOSS" SH.P.K-Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me numër të prokurimit: 622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK – "KK-Prizren" , më datë: 01.02.2021 , mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit tw operatorëve ekonomik N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K-Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me numër të prokurimit: 622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK – "KK-Prizren".

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie te kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me numër të prokurimit: 622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK – "KK-Prizren", dhe lënda të kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e Grupit te operatorëve ekonomik N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K-Prizren, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K-Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 23.12.2020 me nr. 1130/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren" me numër të prokurimit: 622-20-2658-5-1-1 i iniciuar nga AK – "KK-Prizren", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional te prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 06.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi Nr.1

Lidhur me pretendimin e Grupit të OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K – ankues Dyshojmë se ne kontratat e O.E. ALBOSS SH.P.K. dhe KFOR –it përkatësisht kontratat:

a. IFB-TACO-KFOR-19-103 IMPROVEMENT OF APOD MAIN GATE

b. IFB-TACO-KFOR-19—09319-093 REFURBISHMENT OF ËORKDS FOR FLOOD DAMAGE MITITGATION IN MILAPOD

c. IFB-TACO-KFOR-19-094 REFURBISHMENT & REORGANISING OF MAN GATE AT CNH

Dyshojmë se ne këto kontrata është falsifikuar nënshkrimi i personit përgjegjës se KFOR-it konkretisht Znj. REGINE DOUGLAS ku ne te gjitha kontratat nënshkrimi i saj është i përmasave identike pa dallim fare. Ne

e kemi bere krahasimin me matje te sakta te nënshkrimit si dhe ne baze te dukjes vizuale ku nënshkrimin e Znj. DOUGLAS e kemi përshkallëzuar ne përmasën e njëjtë ku dhe e kemi vërejtur përputhshmërinë e te gjitha nënshkrimeve ne te gjitha këto kontrata ku ka rezultuar plotësisht identik.

Përgjigje në pretendimin nr.1

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr.1 të parashtruar nga "Grupit te OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K ankues, mendon se kjo çështje nuk i takon ekspertit shqyrtues per shqyrtim sepse per dhënien e mendimit se nënshkrimi dhe vula është i falsifikuar duhet me qen ekspert i forenzikës,

Njëherit eksperti shqyrtues konstaton se O.E. ALBOSS SH.P.K – e plotëson kriterin e përcaktuar me njoftimin per kontrate : Kërkesën 1. "Projektet e natyrës së kontratës të realizuar ne tri vite te shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) vlera minimalë e ti gjitha projekteve te natyrës së Kontratës duhet te jetë jo me vogël se 1.900.000 €" dhe pa i llogaritur këto kontrata per te cilat AK ka dyshime. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e Grupit te OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K – ankues se OE "ALBOSS" SH.P.K. i shpallur fitues ne Paramasen e ofruar tek rekapitullimi i punëve te mbindërtimit OE ne fjalë e përdor simbolin e valutës $,

Përgjigjeje në pretendimin nr.2

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr.2 të parashtruar nga "Grupit te OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K ankues, duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim si ofertën me çmime Vendimin nr. 880/20 te datës 25.11.2020 te Panelit Shqyrtues i cili vlerëson se ky gabim është një gabim teknik sepse valutën per çmimin per njësi e ka te dhënë ne valutën e përcaktuara me dosjen e tenderit ne baze te se cilës behet pagesa. Prandaj bazuar ne dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim është i pa bazuar. Eksperti shqyrtues se sqaron se bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin e Grupit të OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K – ankues se Grupit te OE Nuk e plotëson Kërkesën "Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri

vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së Kontratës duhet të jetë jo më vogël se 1.900.000 €. OE në fjalë arrin një total të kontratave me vlerë: 1.591.187,39 € Kjo pasi që disa nga kontratat nuk janë të natyrës së njëjtë:

1.Ndërtimi i Terenit sportive ne Lagjen 11 Marsi në Prizren, me nr. të prokurimit 622-18-096-521.- 119,567.70 €

2.Krijimi i ambientit në Kabash dhe Korish si destinacion turistik, me nr. të prokurimit 622-18-117-521. - 71,087.00 €

3.Demolimi i sipërfaqes Charlie në kampin fushor Prizren. -- 444,695.00 €

Ndërsa tek Lista e Kontratave, Kontratat me numër 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42 dhe 43 janë më të vjetra se 3 vite.

Përgjigje në pretendimin nr. 2

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr.2 të parashtruar nga **"Grupit te OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K** ankues, duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim, pretendimit te OE Ankues, Vendimin nr. 880/20 te datës 25.11.2020 te Panelit Shqyrtues i cili konsideron se autoriteti kontraktues duhet te kërkoj sqarime shtese, te vlerësoj dhe vërtetoj nëse keto kontrata janë te natyrës se ngjashme konforme kërkesës se dosjes se tenderit. Eksperti shqyrtues se sqaron se bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së.

AK-ja me datën 19.12.2020 ka bere kërkesën per sqarim te tenderit (sjellja e dëshmive) OE "ALBOSS" SH.P.K. te cilën po e japim me poshtë:

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit (sjellja deshmive)

Prizren : 09/12/2020

Kontraktuesi :Komuna e Prizrenit, Rr. Remzi ademaj, Pn

Tederuesi : "ALBOSS"SH.P.K., Grejkoc, Suhareke, 23000, GREJKOVC

Nr. i prokurimit:	622	2	0	0	4	5	5	1	1

Titulli: Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren

I/e nderuar(a):

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

1.Të na silleni këto dokumenta :

1. Te na sillni te gjitha kontratat dhe referencat (pranimi teknik) të paraqitura ne listën e kontratave dhe referencave.

2. Ndërtimi i objektit të radiologjisë -Faza pare te na sillni transaksionet bankare për ketë kontratë ne mesë të I.SEFERIT dhe Albossit.

Dokumentat e kërkuara duhet të dërgohen (dorëzohen fizikisht në zyrën e prokurimit) ose në e-mail : prokurimipz@hotmail.com dhe e- Prokurimi deri me 15/12/2020 ora 16 00

Pa përgjigjën nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht,

Me respekt,

Isa Osmankaj

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit] *[Nënshkrimi]*

OE sipas kërkesës se AK-se i dorëzon dëshmitë e kërkuara

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit te këtij dokumentacioni si dhe listën e dorëzuar, kontratat si dhe referencat apo pranimin teknik përfundimtar të dorëzuara nga OE, dhe për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore. në tabelën e projekteve tek vërejtjet kam dhënë vlerësimin për secilën kontrate veç e veç dhe në bazë të saj konstatoj se OE Grupit të OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K gjatë periudhës tre vjeçare nga data e publikimit te njoftimit për Kontrate ka realizuar punime te ngjashme ne vlere preje 2,152,0057 euro dhe e plotëson kriterin e kërkuar e cila është në shumen prej 1,900,000,00 euro.

Me poshtë po japim listën e projekteve të kërkuar dhe të klasifikuara sipas natyrës së ndërtimit.

Tabela e projekteve të realizuara gjatë tri viteve të fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë

Nr.	Emri i projektit	Numri i Prokuri	Autoriteti Kontraktues	çmimi kontraktues	Nënshkrimi i Kontratës	kont rata	Reference, ose Pranimi	Projekt	Vërejtjeje

		mit					Teknik Përfundimtar - data	e te Natyrës se kontratës	
1	Ndërtimi i Memorialit të Komandant Drinit në Prizren	622-19-123-521	Komuna e Prizrenit		27.11.2019	PO	JO	PO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
2	Ndërtimi i urës që lidhë fshatin Smaq me komunën e Mamushës	622-19-186-521	Komuna e Prizrenit		13.01.2020	PO	20.05.2020	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar sepse nuk është objekt i ndërtimit te lartë – natyrës se njëjtë
3	Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e objekteve te banimit kolektiv në Prizren	622-19-187-521	Komuna e Prizrenit	235,141.50	21.11.2019	PO	15.07.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
4	Improvement of APOD Main Gate	IFB-TACO-KFOR-19-103	Headquarters Kosovo Force – KFOR		25.11.2019	PO	JO	PO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
5	Ndërtimi i objektit për trajnime EOD në kazermën e FSK-së në Prizren	217-19-3403-521	Ministria e Mbrojtjes	101,802.20	30.07.2019	PO	17.12.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
6	Refirbichment Ëorks For Flood Damage Mititgation In MIL APOD	IFB-TACO-KFOR-19-093	Headquarters Kosovo Force - KFOR		23.07.2019	PO	JO	PO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
7	Refurbishment & Reorganising Of Main Gate at CHN	IFB-TACO-KFOR-19-094	Headquarters Kosovo Force - KFOR		23.07.2019	PO	JO	PO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
8	Enhance Security of Restricted Zone in MIL	40003810	Headquarters Kosovo Force - KFOR		21.03.2019	PO	JO	PO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo

	APOD (HSG ENG 3525)								pranimi teknik përfundimtarë
9	Punimi i kabineteve ne nën kulmin e shkollës Fillore ne Mushnikov e te Prizrenit	622-19-096-521	Komuna e Prizrenit	107,945.38 10,600.00	30.07.2019	PO	14.05.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
10	Ndërtimi i sallës sportive në SHFMU Fadil Hisari në Prizren	622-17-047-521	Komuna e Prizrenit	63,268.00	08.09.2017	PO	21.11.2018	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
11	Restaurimi i Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit	89-9/2019	QRTK-Prizren	38,444.00	18.05.2018	PO	17.12.2018	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
12	Ndërtimi i shkollës ne Busavat Kamenicë	208 17 005 51 I	Ministria e Arsimit	241,645.53	21.04.2017	PO	03.12.2019	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
13	a) Gërmimet e dheut. rregullimi I pllakës nga betoni dhe vendosja e drenazhës b) Lidhja e ujit dhe kanalizimit ne kontejnerin e ri	BM 1801-02 KOS PRZ	KFOR	61,914.00	06.08.2018	PO	26.08.2018	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
14	Sanimi f Fasadës në objektin e shtabit DEU Einsktgt KFOR	1708/B KOS PRZ	KFOR	265,700.20	19.06.2017	PO	30.09.2017	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
15	Rregullimi i rrethojave te terreneve sportive ne Prizren	622-19-094-521	Komuna e Prizrenit	19,444.80	19.07.2019	PO	06.05.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
16	Furnizimi me inventar për objektet	622-19-166-121	Komuna e Prizrenit	22,825.70	20.11.2019	PO	06.05.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar

	ekzistuese ne Prizren								
17	Ndërtimi i terenit sportiv ne lagjen "11 Marsi" ne Prizren	622-18-096-521	Komuna e Prizrenit	119,567.70	02.11.2018	PO	12.05.2020	JO	I plotëson kriteret e kërkuar
18	Fasadimi i objekteve të banimit kolektiv në Komunën e Prizrenit	622-18-108-521	Komuna e Prizrenit	54,967.75	06.11.2018	PO	07.12.2018	JO	I plotëson kriteret e kërkuar
19	Krijimi I ambientit ne kabash dhe Korishë si destinacion turistik	622-18-117-521	Komuna e Prizrenit	71,087.00	15.11.2018	PO	03.10.2020	JO	
20	Ndërtim i Qëndresë së Mjekësisë Familjare në fshatin Romajë në Komunën e Prizrenit	622-18-6727-521	Komuna e Prizrenit		19.10.2018	PO	JO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
21	Ndërtimi i Aneksit të Radiologjis ë faza e (I) parë		I.SEFERI	105,000.00	05.07.2018	PO	24.12.2018	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
22	Punimet ndërtimore dhe zejtare - Ndërtimi i aneksit te objektit te Radiologjis ë Faza II•-(Dyte)	70010-19-4719-5-2-1	Spitali Rajonal-Prizren	187,956.71	16.08.2019	PO	14.05.2020	PO	I plotëson kriteret e kërkuar
23	Punët zejtare dhe instaluese ne renovimin e reparteve te Emergjenc ës dhe Internos	70010-19-3175-521	Spitali Rajonal-Prizren	68,851.59	18.07.2019	JO	14.05.2020	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar Kontrata
24	Demolimi i sipërfaqes Charlie ne kampin fushor Prizren, sipas	MB 260-03 KOS PRZ	KFOR	444,695.00	09.06.2018	PO	26.08.2018	JO	I plotëson kriteret e kërkuar

	ofertës nga përshkrimi teknik								
25	Instalimi i Ventilimit dhe Klimatizimit në repartin e Fizioterapisë	70010-18-746-5-2-1	Spitali Rajonal-Prizren		19.04.2018	JO	JO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar Kontrata dhe as referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
26	Building of neë ëatchtoëers at CFC	IFB-TACO-KFOR-17-097	FILM CITY		28.07.2017	JO	JO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar Kontrata dhe as referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
27	Punimi i sipërfaqeve te betonin ne kampin Prizren	BU 1710 KOS PRZ	KFOR		16.07.2017	JO	JO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar Kontrata dhe as referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
28	Sanimi i ndërtesës së rojës tek porta 2 e Kampit ushtarak "Camp Prizren"	BU 1712 KOS PRZ	KFOR		14.09.2017	JO	JO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është dorëzuar Kontrata dhe as referenca apo pranimi teknik përfundimtarë
29	Rinovimi i parkingut NSE	BM 1810 KOS PRZ	KFOR		28.09.2018	PO	PO	JO	Nuk e plotëson kriterin e kërkuar nuk është objekte i natyrës së njëjtë
Vlera e kontratave te cilat i plotësojnë kriterin e kërkuara me njoftimin për Kontrate: Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, , të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve				2,152,005,.47					

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e grupit të OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K – ankues për operatorët ekonomik të tjerë Autoriteti Kontraktues ka zbatuar ligjin e prokurimit dhe rregulloren duke u mbështetur në nenet dhe në dokumentet qe Ata si OE nuk i plotësojnë kushtet dhe nuk janë të përgjegjshëm për realizimin e projektit.

Përgjigjeje në pretendimin nr. 4

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr. të parashtruar nga "Grupit te OE N.P.N "Alfa-Ing" &"BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K ankues. Vendimin nr. 880/20 te datës 25.11.2020 te Panelit Shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar sepse as njeri nga operatoret ekonomik te cilët janë eliminuar gjate procesit te Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit te Tenderëve nga Autoriteti Kontraktues nuk kanë bërë kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në OSHP për eliminimin e tyre nga procedurat e mëtutjeshme.

Eksperti shqyrtues se sqaron se bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së. Andaj ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues ankesa: Grupit të OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K ankues te merret si e pa bazuar. Andaj dhe rekomandojmë që të anulohet Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit te prokurimit te mbetet ne fuqi B58 -NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES dhe AK-ja të vazhdoj me procedurat në bazë të LPP-së – me nënshkrimin e kontratës.

Autoriteti kontraktues me datë 07.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik me datë 06.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën 27.01.2021, përmes platfomrës elektronike "ZOOM" ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-së ankues, përfaqësuesit e AK-së, si dhe eksperti shqyrtues, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të

prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K, se kontratat e ALBOSS SH.P.K. dhe KFOR-it, përkatësisht kontratat: a. IFB-TACO-KFOR-19-103 IMPROVEMENT OF APOD MAIN GATE, b. IFB-TACO-KFOR-19—09319-093 REFURBISHMENT OF ËORKDS FOR FLOOD DAMAGE MITITGATION IN MILAPOD, c. IFB-TACO-KFOR-19-094 REFURBISHMENT & REORGANISING OF MAN GATE AT CNH, ku OE ankues për këto kontrata potencon se duhet të jenë të falsifikuara sepse nënshkrimi i personit përgjegjës të KFOR-it konkretisht Znj. REGINE DOUGLAS në të gjitha kontratat nënshkrimi i saj është i përmasave identike pa dallim fare. Ne e kemi bere krahasimin me matje te sakta te nënshkrimit si dhe ne baze te dukjes vizuale ku nënshkrimin e Znj. DOUGLAS e kemi përshkallëzuar ne përmasën e njëjtë ku dhe e kemi vërejtur përputhshmërinë e te gjitha nënshkrimeve ne te gjitha këto kontrata ku ka rezultuar plotësisht identik.
Paneli Shqyrtues sqaron se me qëllim të eliminimit të këtyre dyshimeve, AK duhet që konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë nga KFOR-i, duke kërkuar nga KFORI që të deklarohen për këto kontrata dhe të sqarojnë nëse vërtetësia e këtyre kontratave është e saktë sipas tenderit të dorëzuar nga OE i rekomanduar.

Lidhur me pretendimin tjetër të grupit të OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K, se OE i rekomanduar "ALBOSS" SH.P.K. i shpallur fitues, tek para masa e ofruar tek rekapitullimi i punëve të mbindërtimit, në fjalë e përdor simbolin e valutës $.
Paneli Shqyrtues sqaron se për këtë çështje është vendosur në vendimin PSH.nr.880/20 të datës 25.11.2020 të Panelit Shqyrtues, i cili vlerëson se ky gabim është një gabim teknik sepse valutën për çmimin për njësi e ka të dhënë në valutën e përcaktuara me dosjen e tenderit në bazë të së cilës bëhet pagesa. Prandaj ky pretendim është i pa bazuar. Po ashtu, bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K, se grupi i OE nuk e plotëson Kërkesën "Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës

së Kontratës duhet të jetë jo më vogël se 1.900.000 €. OE në fjalë arrin një total të kontratave me vlerë 1.591.187,39€. Kjo pasi që disa nga kontratat nuk janë të natyrës së njëjtë:

1.Ndërtimi i Terenit sportive ne Lagjen 11 Marsi në Prizren, me nr. të prokurimit 622-18-096-521.- 119,567.70 €

2.Krijimi i ambientit në Kabash dhe Korish si destinacion turistik, me nr. të prokurimit 622-18-117-521. - 71,087.00 €

3.Demolimi i sipërfaqes Charlie në kampin fushor Prizren. -- 444,695.00 €

Ndërsa tek Lista e Kontratave, Kontratat me numër 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42 dhe 43 janë më të vjetra se 3 vite.

Për këtë pretendim ankimor, Paneli Shqyrtues në vendimin PSH.nr.880/20 të datës 25.11.2020 e ka udhëzuar autoritetin kontraktues që të kërkoj sqarime shtesë, të vlerësoj dhe vërtetoj nëse këto kontrata janë të natyrës së ngjashme konform kërkesës së dosjes së tenderit. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së. Mirëpo, AK-ja me datën 19.12.2020 ka bërë kërkesë për sqarim të tenderit (sjellja e dëshmive) OE "ALBOSS" SH.P.K., duke kërkuar që OE ti sjell të gjitha kontratat dhe referencat (pranimi teknik) të paraqitura në listën e kontratave dhe referencave, si dhe për ndërtimin e objektit të radiologjisë – Faza e parë të sjellën transaksionet bankare për këtë kontratë në mes të I. Seferit dhe Albossit. Lidhur me këtë kërkesë të AK-së, OE i dorëzon këto dokumente, ku disa kontrata nuk e plotësojnë kriterin e kërkuar sepse nuk është dorëzuar referenca, disa kontrata nuk e plotësojnë kriterin sepse nuk janë objekte të ndërtimit të lartë, etj. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të merr parasysh vetëm kontratat të cilat janë konform kërkesës së AK-së.

Lidhur me pretendimin tjetër të grupit të OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K për operatorët ekonomik të tjerë, Autoriteti Kontraktues ka zbatuar ligjin e prokurimit dhe rregulloren duke u mbështetur në nenet dhe në dokumentet qe Ata si OE nuk i plotësojnë kushtet dhe nuk janë të përgjegjshëm për realizimin e projektit.

Paneli Shqyrtues sqaron se në vendimin PSH.nr.880/20 të datës 25.11.2020 të Panelit Shqyrtues është vlerësuar se pretendimi ankimor është i bazuar sepse as njeri nga operatoret ekonomik të cilët janë eliminuar gjatë procesit të Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit te Tenderëve nga Autoriteti Kontraktues nuk kanë bërë kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në OSHP për eliminimin e tyre nga procedurat e mëtutjeshme. Në anën tjetër, duke u bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2)dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe

palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së. Andaj ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve dhe analizës konkrete, vjen në përfundim se AK me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka vepruar konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të kërkoj nga KFOR-i verifikimin e kontratave të cilat i ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë. Gjithashtu, AK të analizoj kërkesën e vet të caktuar në dosje të tenderit dhe kontratat me referenca, pasi që kontratat të cilat nuk kanë referenca apo pranime teknike ose nuk janë të ndërtimit të lartë, nuk mund të merren parasysh.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK PRIZREN";

1x1 OE N.P.N "Alfa-Ing" & "BM Group" SH.P.K & "Renelual Tahiri" SH.P.K;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.